

NJOFTIM PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS KONKURUESE PËR MARRJE AMBJENTI ME QIRA PËR KOPSHTIN PRANË SHKOLLËS 9-vjecare "PREN SIMONI" DRAC, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM , BASHKIA DURRËS.

Njoftim për zhvillimin e procedurës konkurruese për marrje ambienti me qira për kopshtin pranë shkollës 9-vjecare "Pren Simoni", Drac, njësia administrative Ishëm nga data 27.11.2024-05.12.2024 me qëllim përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative.

A.Kriteret, specifikimet e ambientit dhe dokumentacioni që kërkohet nga ofertuesi qiradhënës.

- Sipërfaqe jo më të vogël se 50 m<sup>2</sup> (hapësira dhome e fëmijëve min 30 m<sup>2</sup> +banjo funksionale +koridor +amb.ndihmës )
- Të pozicionohet afër zonës së banimit dhe të jetë lehtësisht e aksesueshme nga popullata e interesuar për shërbimin.
- Të jetë i pozicionuar në katin mbi tokë.
- Ambienti i jashtëm oborri (nëse disponohet) të jetë i rrethuar që të garantojë siguri tek fëmijët.
- Akses i kopësht të jetë i vecantë ,i destinuar vetëm për fëmijët .
- Të jetë i pozicionuar në një zonë të aksesueshme nga mjetet zjarrfikëse.
- Sistemi i furnizimit me ujë dhe energji elektrike të jetë në funksion të pandërprerë dhe kapacitet për të përballuar ngrohje-ftohjen.
- Ndricimi elektrik të jetë i përshtatshëm
- Të mundësojë ndricim dhe ajrim natyral.
- Dyshemeja e objektit të jetë material jo rrëshqitës
- Materiali i godinës rezistent ndaj zjarrit.

Vlera e qirasë nuk duhet të jetë më e vogël se 202.5 lekë/m<sup>2</sup> dhe 141.75 lekë/m<sup>2</sup> (sipërfaqe ndërtesë ) për ndërtesa të privatizuara me ligjin 7652 datë 23.12.1992" Për privatizimin e banesave shtetërore"

Dokumentacioni i kërkuar i cili do të jetë pjesë integrale e ofertës:

- Kërkesa e individit/subjektit për pjesëmarrje në konkurim.
- Kopja e dokumentit të identifikimit.
- Certifikata e pronësisë , ku të jetë specifikuar ambienti që do të jepet me qira, si dhe të jetë përcaktuar qartë sipërfaqja në m<sup>2</sup>.Ky dokument të shoqërohet me kartelë të rifreskuar të pasurisë së paluajtshme ,hartë treguese dhe planimetri të detajuar të ambientit që do te jepet me qira.
- Deklarata e hollësishme e ofertuesit për vënien në funksionim të objektit, për veprimtarinë kërkuar.
- Përshkrimi i ambientit shoqëruar me foto .
- Oferta me vlerën mujore të qirasë (cmimi/m<sup>2</sup>)
- Akti administrativ zyrtar që objekti rezulton i rregullt nga ana inxhinierike dhe ndërtimore si dhe akt konstatimin që rezulton i banueshëm (nga Njësia Administrative Ishëm).

- Libreza e kontratës së energjisë elektrike dhe ujit, ose një faturë të lëshuar përkatësisht nga FSHU dhe UKT) në emër të aplikuesit.
- Vërtetimi nga institucioni përkatës që subjekti nuk ka detyrime të papaguara të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë, në lidhje me kontratat për furnizimin e objektit që do të jepet me qira.
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që : nuk është në ndjekje penale, nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, nuk është i dënuar / nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës së formës së prerë dhe nuk ndodhet në proces gjyqësor civil .

Nëse ofertuesi është subjekt fizik /juridik

- Vërtetimi që nuk është dënuar për ndonjë vepër penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë.
- Vërtetimi që nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë.
- Dokument që vërteton se subjekti nuk ka detyrime ndaj organeve tatimore.
- Të gjitha dokumentat duhet të jenë në emër të aplikuesit.

B. Kohëzgjatja minimale 12 muaj –nga momenti i lidhjes se kontrates.

C. Dokumentacioni duhet të jetë original ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve të fundit . Dokumentacioni duhet dorëzuar pranë zyrës së Marëdhënieve me Publikun, deri me datë 05.12.2024 ora 10:00.